



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr: **56/2024**

Data: **14.10.2024, ora 13:30**

Vendi: **Zyrat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanja, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj Kurtis,

Në takim ishin të Mufera Shinik

pranishëm:

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Procesverbali i mbledhjes së KQZ Nr.53, 54 dhe 55/2024

3. Aktivitetet e SKQZ

4. Raportet e Këshillave

4.1.1 Shqyrtimi dhe miratimi i Qarkores së Buxhetit 2025/2, qarkorja finale dhe kufijtë buxhetor.

5. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kryetari Radoniqi, kryesoi takimin e radhës të KQZ-së. Fillimisht, u paraqitë agjenda e mbledhjes e cila u miratua nga anëtarët e pranishëm. Anëtarët e KQZ-së, miratuan në vazhdim procesverbalet e mbledhjeve të KQZ nr.53, 54 dhe 55/2024.

2. Aktivitetet e SKQZ:

Besnik Buzhala, paraqiti raportin e Sekretariatit mes dy takimeve, kryesisht lidhur me mbarëvajtjen e organizimit të procesit zgjedhor. Ai, referoi për tri aktivitetet e procesit: Periudha e shërbimit të votuesve për ndërrimin e QV; Periudha e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës; Programi orientues me Komisionet Komunale Zgjedhore. Periudha e shërbimit të votuesve për ndërrimin e Qendrave të Votimit. Z. Buzhala, lidhur me pikën e parë tha se që nga fillimi i shërbimit të votuesve për ndërrimin e qendrave të votimit që ka filluar me datën 29.08.2024 dhe që përfundon me datën 26.12.2024, janë paraqitur 892 kërkesa për ndërrimin e qendrës së votimit. Prej tyre, 703 aplikime janë bërë përmes sistemit elektronik, dhe 189 në zyrat e KKZ –ve përmes formularëve. Në total, prej 892 kërkesave, janë aprovuar 866 kërkesa, ndërsa janë refuzuar 26 kërkesa.

Lidhur me periudhat e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës, proces ky që ka filluar më datën 29.08.2024 dhe përfundon me datën 26.12.2024, kanë aplikuar për regjistrim si votues 7,227 votues kanë aplikuar për tu regjistruar si votues jashtë Kosovës: 6,634 kërkesa janë aprovuar, ndërsa 593 kërkesa janë refuzuar. Përmes postës janë pranuar 3 aplikacione të cilat nuk janë proceduar, për arsye se janë dërguar fizikisht nga aplikuesit në postën e Kosovës, pra vula dhe pulla postare kanë qenë të Kosovës, jo të shtetit ku jetojnë. Aplikuesit janë njoftuar për mundësinë e ri aplikimit përmes platformës elektronike.

Në raportin e tij lidhur me programin orientues me Komisionet Komunale Zgjedhore, z. Buzhala tha se programi ka filluar me datën 4 tetor 2024, dhe janë zhvilluar takime në Mitrovicën e Jugut (04.10.2024), në Mitrovicën e Veriut (datë 05.10.2024), pastaj në Pejë më 07.10.2024, në Prizren më 08.10.2024, në Gjilan më 09.10.2024, në Ferizaj më 11.10.2024 dhe në Gjakovë, më datën 12 tetor 2024. I njëjti program, do të vazhdoj të implementohet edhe në dy takime në Prishtinë.

Fazli Stollaj, pyeti rreth regjistrimit. Ai tha se, ka pasur momente kur sistemi ka ra për shkak të madhësisë së dokumenteve. Nuk ka pasur qartësi, mirë është që të kontaktohen kontraktorët dhe të shihet mundësia e zvogëlimit të dokumenteve, fotografive...

3. Raportet e Këshillave

Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i Qarkores së Buxhetit 2025/2, qarkorja finale dhe kufijtë buxhetor:

Gordana Llaban: Sot në takimin e këshillit, e kemi shqyrtuar qarkoren e Buxhetit 2025/2 të cilën na e ka dërguar Ministria e Financave. Është një qarkore finale e kufijve buxhetor. Në raport me planin e miratuar të zgjedhjeve dhe të shpenzimeve të KQZ-së, buxheti i planifikuar i KQZ-së për vitin 20125, është: 23, 239, 332, 00 euro. Megjithatë, buxheti i KQZ –së sipas planifikimit për të dy kategoritë ekonomike, është më i madh: pagat dhe mëditjet janë më shumë për 257, 082 euro (15 vende më tepër), dhe në kategoritë ekonomike mallra dhe shërbime, 654, 614, 69 euro. Në tërësi, buxheti ynë, është planifikuar më shumë për 911, 697 euro, nga sa është qarkorja buxhetore. Në takim, jemi pajtuar që të shohim se pse është buxheti ynë më i madh, dhe duhet arsyetuar kjo sepse jemi në proces zgjedhor.

Sami Hamiti, tha se e kemi shqyrtuar buxhetin. Një pjesë e parë, jemi në rregull por në dy kategoritë e përmendura, kemi planifikim më të madh. Nga sekretariati, duhet të bëhet një shkresë e mirë, e arsyeshme, dhe të kërkojmë që të plotësohet – të rritet shuma në qarkore. Besoj, do ta shpjegojmë se pse, qysh. Të kihet parasysh diferenca, njerëzit veç janë duke punuar dhe unë besoj se do të mirëkuptohet...

Sami Kurteshi, pyeti lidhur me shpenzimet komunale. Është një shifër 28, 100 euro. A janë llogaritë këto për QNK, për QNR dhe KQZ, ju besoj, e dini...

Sami Hamiti: Kjo pjesë, është për objektin tonë, dhe QNR. Janë shërbime, pastrime etj.

Në fund, kryetari **Radoniqi** kërkoi miratimin. Me 10 vota për, anëtarët e KQZ –së miratuan “Qarkoren finale të kufijve të Buxhetit 2025/2”.

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtim dhe miratimi i anëtarit të KKZ-së në komunën e Obiliqit

Arianit Elshani, tha se është shqyrtuar kërkesën propozimin për anëtar të KKZ-së për komunën e Obiliqit për zhgjedhjet e 9 shkurtit. Ky, është zëvendësim, dhe është brenda afatit. Rekomandojmë miratimin lidhur me këtë zëvendësim.

Kreshnik Radoniqi: Stefan Radosavleviq, sipas rekomandimit të KOZ, emërohet anëtarë i KKZ-së në komunën e Obiliqit, nga subjekti politik GI SPO. Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, me 10 vota për miratuan këtë zëvendësim.

Shqyrtimi dhe miratimi i ridestnimit të mjeteve buxhetore brenda të njëjtes kategori

Besnik Buzhala, tha se është një kërkesë për regjistrim të mjeteve në kodin e projektit “935” për pajisje me teknologji informative për Qendrën Komunale të Numërimit. Kanë tepruar rreth 200 mijë euro. Në kuadër të kësaj shume, Sekretariati kërkon që vlera e 94 eurove nga kjo shumë, të destinohet për blerjen e veturave të KQZ. Pra, kjo shumë të ridestionohet për këtë qëllim.

Alban Krasniqi, tha se te programi i zgjedhjeve “kategoria kapitale”, këtë pjesë prej softverit ta bartim për blerjen e automjeteve. Ne, kemi komunikue me institucionet relevante dhe jemi në kontakt. Të shohim se mundemi me u furnizue me 4 makina, pra në këtë vit...!

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë kërkesë.

Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës nga organizata Internechenell Idea

Kreshnik Radoniqi: E kemi marrë një ftesë nga kjo organizatë dhe kemi miratuar pjesëmarrjen në një trajnim. Kur e kemi shqyrtuar këtë ftesë, kemi vendosur me marrë pjesë Alban Krasniqi dhe Kreshnik Spahiu. Por, ka ardhur një kërkesë që të jem edhe unë pjesë e këtij trajnimi që do të mbahet më 3-5 dhjetor në Tiranë.

E hedh në votim. Kush është për miratimin e kësaj kërkesë ? Unë abstenoj...

Me 9 vota për, miratohet kjo kërkesë...

Të ndryshme !

Gordana Llaban: Një pyetje e kam. Çfarë ndodh me zyrtarët në veri, a janë pranuar ata...?

Besnik Buzhala: Po, zyrtarët e komunave në veri janë pranuar. Sekretariati këtë javë do të marrë veprime për akomodimin e tyre. Dhe brenda kësaj jave, ata duhet të fillojnë punën...

Sami Kurteshi: Është fjala vetëm për katër komuna në veri, apo ka edhe tjera...?

Besnik Buzhala: Jo, ka rast në Malishevë që zyrtarja jonë zëvendësohet përkohësisht për shkaqe të lehonisë, dhe në Gjilan, është zëvendësua ish kryesuesi sepse ka dalë në pension. Të njëjtin, janë zëvendësuar me të njëjtat procedura.